



QYTETI I SHKUPIT

Shpallje për qasje në Draft-PALE 3 të Qytetit të Shkupit dhe Draft-Raportin VSJM për dokumentin planifikues

Qyteti i Shkupit njofton publikun e interesuar se është përgatitur **Draft – Plani Aksionar Lokal Ekologjik PALE 3 i Qyteti të Shkupit për periudhën 2020 – 2026 dhe Draft-Raporti për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit Jetësor – VSMJ për PALE 3 të Qytetit të Shkupit për periudhën 2020 – 2026**. Në përputhje me rregullativën ekzistuese ligjore (neni 69 i Ligjit për Mjedisin Jetësor (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 51/11, 123/12, 93/13, 42/14, 44/15, 129/15, 39/16 dhe 113/18) dhe Dekretit për pjesëmarrjen e publikut gjatë përgatitjes së dispozitave dhe akteve të tjera, si dhe planeve dhe programeve nga fusha e mjedisit jetësor (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 147/08), PALE dhe VSMJ janë në dispozicion për kontroll publik në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit.

Duke pasur parasysh situatën e krijuar me virusin Kovid 19, dhe në pajtim me masat dhe rekomandimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për ndalimin e tubimeve masive, nuk ekzistojnë kushte për debat publik, domethënë debati publik nuk do mbahet. Për të siguruar pjesëmarrjen e publikut, ju lutemi të gjitha palëve të interesuara, nëse kanë vërejtje, propozime dhe mendime në lidhje me Draft-Propozimin, t'i depozitojnë pranë Qyteti të Shkupit në një afat prej 30 ditësh nga dita e shpalljes së këtij informacioni, pikërisht në periudhën nga **06.10.2020 deri më 06.11.2020**. Të njëjtat mund t'i dërgoni në adresën e-mail: **Kristina.Spasikj@skopje.gov.mk** ose nëpërmjet postës në adresën e mëposhtme: **Qyteti i Shkupit, Sektori për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor, bul. Ilinden mnr.82, 1000 Shkup**.

Qyteti i Shkupit